



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0049042-5/24 dt. 31.07.2024
Mitrovicë



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 31.07.2024, pasi shqyrtoi Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2023 dhe Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023; me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0044310-3/24 dt. 11.07.2024); sjell këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023

1. MIRATOHET Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023.
2. Pjesë e këtij vendimi është Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe zyrtarët përgjegjës të përcaktuar në plan.
4. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Të gjitha drejtorive